

Nr. 47 Prot
1Durrës, më 30.01. 2026

Lënda: Në përgjigje të kërkesës suaj.

Z.

Adresa:

Në vijim të kërkesës suaj, me tonën Nr. 47 Prot, datë 19.01.2026; e regjistruar në zbatim të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (i ndryshuar), në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve me nr. rendor 2, date 19.01.2026, me objekt: “*Informacion zyrtar mbi zhvillimin e projektit ekzistues të hekurudhës, në Rrugën Jordan Misja, Tiranë dhe përcaktimin e distancës ligjore të objekteve nga trupi hekurudhor, për qëllime legalizimi*”, ju parashtrojmë për sa më poshtë vijon:

Lidhur me ankimin administrativ të depozituar, Hekurudha Shqiptare i referohet informacionit mbi distancat minimale ligjore dhe teknike, që duhet të respektohen nga objektet ekzistuese kundrejtë trasese së hekurudhës, që përcaktohet qartë nga legjislacioni në fuqi, konkretisht në nenin 5 dhe 118/2 të Ligjit Nr. 142/2016 “*Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë*”.

Për ndërtimin e çdo lloj objekti, që ndodhet në zonat urbane, jashtë brezit të vijës hekurudhore dhe në distancë deri në 25 metra nga ky brez, kërkohet leje nga administruesi i infrastrukturës hekurudhore.

Në vijim të kërkesës suaj, ekipi teknik i Hekurudhës Shqiptare, verifikoi nga afër raportin e objektit me linjën hekurudhore ekzistuese dhe beri matjen respektive të distancës së tyre. Bazuar në verifikimet e bëra, distanca nga fundi i skarpatës me objektin është 5.5 m. Gjithashtu, trupi i trasesë së linjës hekurudhore ekzistuese, është në lartësi afërsisht mbi 2 m mbi sipërfaqen e tokës së objektit në fjalë.

Vlen të theksojmë se “Hekurudha Shqiptare” sha, është në fazën e përgatitjes së “*Studimit të Projektit të detajuar të linjës hekurudhore Terminali i Transportit publik-Stacioni i trenit Tiranë (4 KM) si zgjatim i Linjës Hekurudhore Durrës- Tiranë*”. Për rrjedhojë, nuk disponojmë të dhëna përfundimtare të projektit në raport me objektin që synohet të legalizohet.

Si konkluzion, bazuar në inspektimin në terren dhe fazën në të cilën ndodhet projekti në funksion të linjës hekurudhore Terminali i Transportit publik-Stacioni i trenit Tiranë, Hekurudha Shqiptare ndodhet përballë rrethanave që pamundësojnë miratimin e vijimit të procesit të legalizimit. Kjo

çështje mund të rishikohet pas përfundimit dhe miratimit të projektit të detajuar të linjës hekurudhore.

Sqarojmë se “Hekurudha Shqiptare” sha, për çdo procedurë legalizimi, në referim të kuadrit ligjor hekurudhor, mban qëndrim e saj në raport me procedurën që vendos në dispozicion Agjensia Shtetërore e Kadastrës.

Me konsideratë!